



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT**

Nr. _____ Prot.

Tiranë, __.__.2022

NJOFTIM

PËR

SHPALLJEN E SHPREHJES SË INTERESIT NGA ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE / MBROJTËSIT E TË DREJTAVE TË NJERIUT, PËR TË QENË PJESË E KOMISIONIT TË VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE PËR KOMISIONER NË INSTITUCIONIN E AVOKATIT TË POPULLIT

Të nderuar përfaqësues të Organizatave të Shoqërisë Civile/Mbrojtës të të drejtave të njeriut!

Në zbatim të nenit 33/1, pika 4 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, Institucioni i Avokatit të Popullit ka shpallur konkurimin për 3 (tre) vende vakant për Komisioner dhe konkretisht:

- ✓ *Komisioner në Seksionin për policinë, shërbimin sekret, burgjet, Forcat e Armatosura dhe pushtetin gjyqësor;*
- ✓ *Komisioner në Seksionin e Përgjithshëm;*
- ✓ *Komisioner në Seksionin për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre.*

Duke pasur parasysh që procesi i përzgjedhjes për shqyrtimin dhe vlerësimin e kandidaturave për Komisioner në institucionin e Avokatit të Popullit organizohet në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile apo mbrojtësit e të drejtave të njeriut, institucioni i Avokatit të Popullit:

I bën thirrje të gjithë individëve/organizatave që veprojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut të cilat lidhen me fushën e veprimtarisë së Seksioneve përkatëse, të shprehin interesin e tyre për të qenë pjesë e këtij procesi përzgjedhës, brenda datës 09.01.2023, përmes konfirmimit në adresën e postës elektronike: ap@avokatipopullit.gov.al .

Ju falenderojmë për bashkëpunimin!